



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.67/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Ali Salihu, ka paraqitur apel kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 22.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt apeli i Ali Salihu, me numër Anr.67/2019 e datës 20.09.2019, e parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 20.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Ali Salihu, me të cilën pretendon se ka aplikuar për regjistrim jashtë vendit për zgjedhjet e parakohshme 2019, po ashtu ju është konfirmuar se ju ka pranuar regjistrimi mirëpo emri i tij nuk është në listën e votuesve, edhe pse siq thekson dokumentacionin e ka në rregull.

Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur formularin e aplikimit jashtë Kosovës, së bashku me kopjet e dokumentit e identifikimit valid.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i parashtruar nga ana e Ali Salihu është i parregullt, dhe si i tillë apeli nuk i plotëson standardet e kërkuara sipas nenit 10 par.7 dhe nenit 5 par.7 të Rregullës Nr.02/2015.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e cekur më lartë.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e sipërshënuara e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.67/2019 më datën 22.09.2019.

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.